



A.V.E. Consulting

Rr. Tish Daija; Pall. 7; Ap 28

Kompleksi "KIKA I RI"

Phone 00355 68 40 55 663

E-mail : ave_consulting@yahoo.com

RAPORTI I PUNIMEVE TOPOGRAFIK

“RIKUALIFIKIMI I SHESHIT ITALIA”

Ing.Topograf:

Adrian Bulku





Phone 00355 66 40 55 663
E-mail: ave_consulting@yahoo.com

Permbajtja

Permbajtja.....	2
I. Hyrje dhe pozicionimi gjeografik i objektit	3
II. Instrumentat dhe metodologjia	4
III. Ndertimi i rrjetit mbeshtetes ne terren.....	5
IV. Dorezimi i punes	7
V.Koordinatat dhe kuotat e aksit te rruges.....	8



1- Hyrje dhe pozicioni gjeografik i objektit

Ne respektim te termave te references te projektit te sipercituar:

"Raporti perfundimtar i Punimeve Topografike duhet te permbaje te gjithe informacionin e rendesishem topografik i cili nevojitet gjate fazes se hartimit te projekt zbatimit si dhe te asaj te fazes se zbatimit te punimeve. Ne kete faze konsulenti do te paraqese nje raport te sakte te vendodhjes se pikave kryesore te vendosura prej tij per zbatimin e punimeve. Sistemi i referimit te jete i pranuar ne baze te standarteve ne fuqi.

Punimet topografike filluan nga rikonicioni dhe njohja me vendin ku realizohet objekti.



Pozicioni gjeografik i objektit " Sheshi Italia "

Tirana (fragment)

Sheshi Italia i pozicionuar ne qytetin e Tiranës me sipërfaqe afërsisht 6000 m², kufizohet nga: Ne veri nga "Pallati i Kongreseve", ne jug nga "Rr. Leke Dukagjini", ne lindje nga "Stadiumi Qemal Stafa", ne perendim nga "Kolonat".



2- Instrumentat dhe Metodologjia

Zgjedhja e instrumentave dhe aparaturave matese.

Duke njohur tashme karakteristikat e situates urbane , e cila ne teresine e saj eshte zone me dendesi urbane te larte dhe vizualitet te kufizuar, Grupi topografik zgjodhi dhe operoi ne terren me Total Station " TRIMBLE " S6, si per ndertimin e rrjetit mbeshtetes dhe kompletimin e detajeve te relievit .

Karakteristikat fiziko - teknike te kesaj aparature si dhe saktesia e garantuara ne percaktimin e pozicionit te pikes, se bashku me kompatibilitetin e perpunimit te te dhenave ne programet kompjuterike si edhe metodika e matjes , garantojne saktesine e kerkuar nga parametrat teknike te projektimit dhe te zbatimit.

Sistemi i referimit do te jete WGS84 (Sistemi boteror Geodetik) dhe parametrat e projektimit do te respektojne parametrat e UTM (Universal Mercator's Traverse) zona 34 veri.

Referenca altimetrike eshte pranuar, duke i dhene kuoten 111.796 m pikes fillestares Ak.01

Te dhena teknike e instrumentit Total Station TRIMBLE S6


Saktesia e matjeve instrumentale

<i>Matjet</i>	<i>Vlerat</i>
<i>Matje gjatesore Standart</i>	$\pm 0.003 \text{ m} + 3\text{ppm}$
<i>Matje gjatesore Standat(e pershpejtuar)</i>	$\pm 0.010 \text{ m} + 3\text{ppm}$
<i>Matje kendore (deviacioni standart DIN 1873)</i>	$\pm 2 \text{ ''} (0.5 \text{ mgon})$



3- Ndertimi i rrjetit mbeshtetes ne terren

Pozicionet e pikave mbeshtetese u zgjodhen pervec kriterit teknik , (ne vende te hapura dhe me shikim hapsinor te kenaqshem dhe gjatesi te pranueshme) u tregua kujdes edhe zgjedhjen e pozicioneve sipas mundesise lokale dhe lehtesisht te identifikueshme si dhe strukturave te qendrueshme, kryesisht bordure trotuari, sheshe betoni , duke u fiksuar me gozhide betoni.



Skema e rrjetit mbeshtetes (Poligonometria)



Phone 00355 66 40 55 663
E-mail: ave_consulting@yahoo.com

Koordinatat e pikes AK.01 N:4574638.985, E:401534.689, u pranuan si koordinatat fillestare te te gjithë rrjetit mbeshtetes qe do te ndertohej per gjithë rlevimin e zones.

Sistemi altimetrik referues u pranua kuota 111.796 m mbi piken e fiksuar (AK.01).

Ne Ndertimin e rrjetit te pikave te poligonometrise eshte mbajtur ne konsiderate edhe sherbimi qe do realizojne keto pika gjate zbatimit te punimeve si referenca mbeshtetese per zbatimin e punimeve.

Rrjeti mbeshtetes per vete shtrirjen pergjat gjithë siperfaqes se sheshit Italia , konfiguron skemen e poligonit te hapur. Poligonometria u mat me metodiken vajtje ardhje.

Perfundimet e ketyre matjeve rezultuan brenda saktetise se garantuar , DHE SAKTESUAM KOORDINATAT PERFUNDIMTARE TE PIKAVE TE RRJETIT MBESHTETES MBAS PERFUNDIMIT TE MATJEVE NE POLIGONOMETRI KALUAM NE RILEVIMIN E ZONES.

Poligonometria perbehet gjithsej nga 4 pika referuese nga te cilat nje eshte pika baze (AK.01) dhe te tjerat poligone pune. Pavaresisht nga cilesimi i tyre te gjitha pikat garantojne saktesine :

Horizontal

$\pm 1 \text{ mm} + 1 \text{ ppm RMS}$

Vertical

$\pm 1 \text{ mm} + 1 \text{ ppm RMS}$





4- Dorezimi i Punes

Pas perfundimit te matjeve dhe perpunimit te tyre do te dorezohen:

- Relievi i situates faktike i sheshit Italia i digitalizuar ne file dwg (autocad).
- Katalogu i Koordinatave dhe Kuotave te rrjetit mbeshtetes (4 Pika nga Poligonometria) i digitalizuar dhe format A4.
- CD me permbajtjen e siperpermend


Katalogu i Koordinatave dhe Kuotave te rrjetit mbeshtetes

AK	Veri (m)	Lindje (m)	Kuota (m)	Pershkrimi
1	4574638.985	401534.6890	111.796	Baza Fillestare
2	4574719.250	401448.594	121.178	baze
3	4574771.750	401438.491	121.186	baze
4	4574840.447	401444.274	128.149	baze





4- Koordinatat dhe kuotat e aksit te rruges



Planimetria e Sistemimit te sheshit Italia





Phone 00355 66 40 55 663
E-mail: ave_consulting@yahoo.com

Katalogu I Koordinatave dhe Kuotave te aksit rruges

Pika	Veri (m)	Lindje (m)	Kuota (m)	Pershkrimi
F	4574833.620	401470.768	+111.04	Fillimi i rruges
M	4574808.5444	401342.085	+109.70	Mbarimi i rruges

